



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 629/2 Prot.

Vorë, më 05.02.2024

SHPALLJE PËR POZICION TË LIRË PUNE
NË STRUKTURËN E POLICISË SË BASHKISË VORË

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ligjit Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, ligji nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” I ndryshuar, Bashkia Vorë fton të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Policinë Bashkiake si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të policisë bashkiake.

Misoni

Policia Bashkiake ka si mison ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së pnëve publike, mirëadministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridikzionit të saj.

Detyrat edhe përgjegjësítë

1. Siguron zbatimin e aktevetë nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak;
2. Parandalon konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administartive përmes forcimit, inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brënda territorit të juridikzionit të saj;
3. Merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
4. Kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridikzionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit.
5. Bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikqyrjen e sigurisë brënda territorit të juridikzionit të saj;
6. Bashkërendon masat me Policinë e Shtetit pë ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteteve në territorin e juridikzionit të bashkisë;

7. Merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;
8. Merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe atyre që administrohen nga ana e saj;
9. Mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;
10. Mbikëqyr respektimin e normave detyruese të bashkëjetesës ;
11. Siguron ekzekutimin e sanksioneve në lidhje me zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesave sociale me qira , të vendosura nga entet menaxhuese;
12. Bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin , natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;
13. Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare, brigjeve të tyre, zonave ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to;
14. Siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;
15. Mbështet strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtaritë e tyre;
16. siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirave publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjes së mbeturinave dhe mbrojtjen e lulishteve publike;
17. Vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;
18. Siguron zbatimin e rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezavene territorin e juriqisyonit të bashkisë;
19. Garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandiste në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë cdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

Kushtet e punës

Shërbimi i Policisë Bashkiake i kryen detyrat duke qenë në gadishmëri 16 orë ne ditë me ndarje në 2 turne , për të vepruar në çdo rast.

Shërbimi kryhet në grupe të përbërë nga 4 punonjës:

- 1 (një) punonjës policie , përgjegjës turni
- 1 (një) punonjës policie
- 1 (një) shofer
- 1 (një) punonjës policie.

Grupi kryen shërbim çdo ditë.

Ditën e shtunë dhe ditën e djelë operohet vetëm me një turn në shërbim 8 orë.

Pagat dhe përfitimet

Punonjësi i shërbimit të Policisë Bashkiake, përfiton :

- a) pagë mujore, dhe shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi ;

Procedurat e trajtimit finansiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të policisë bashkiakë , përcaktohen me vendim të Këshillit të Bashkisë .

Kriteret e domosdoshme për zgjedhjen e aplikantëve:

Për pranimin në pozicionin polic në bashki, kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse ;
- d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm/ lartë ;
- dh) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e)Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
- f) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policië së Shtetit; të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë .

Dokumentacioni mënyra dhe afati i dorëzimi:

1. Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda datës **02.03.2024**. Dokumentat që nuk dorëzohen brenda këtij afati nuk pranohen.
2. Dokumenat që duhet të paraqiten janë:
 - Kërkesë drejtuar institucionit të bashkisë ;
 - Diplomë të njëhsuar me origjinalin të arsimit të mesëm/të lartë ;
 - Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjendje të mirë shëndetësore”;
 - Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit, nëse është rasti;
 - Vetdeklarim i gjendjes gjyqësore;
 - Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
 - Curriculum Vitae;
 - Certifikatë familjare;
 - Kopje të kartës së identitetit;
 - Certifikata, trajnime profesionale nëse ka;
 - Librezë pune të njëhsuar me origjinalin;
 - Leje drejtimi për kategori B .
 - Vërtetim besueshmërie.
3. Mungesa e njërit prej dokumentave të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumentave sjell skualifikimin e kandidatit.

Në datën **08.03.2024** Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkise Vorë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e aplikimit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i kriteret e aplikimit do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vorë , nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitet mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë e tyre mbi:

- Ligjin nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”
- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”
- Rregulloren e Policisë së Bashkisë Vorë.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Testimi me shkrim

Kandidatët në testimin me shkrim do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;

Kandidatët që marrin 60% të pikëve të testiminit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e Testimit fizik

Testimi fizik

Testimit fizik u nënshtrohen të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses testimini me shkrim për pranim në Policinë Bashkiake. Do të testohen aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

Kandidati që merr mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimini e aftësive fizike vazhdon konkurrimin.

Intervista

Kandidatët, që rezultojnë fitues në fazat e tjera të testimeve, i nënshtrohen intervistës.

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në Intervistë, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;
- b) intervista, deri në 10 pikë.

Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është	60 pikë
Vlerësimi maksimal për testimin e aftesive fizike është	20 pikë
Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është	20 pikë

Kandidatët që marrin mbi 60 pikë janë kandidatët fitues.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, për çdo fazë (testimit me shkrim, testimit fizik dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendat e informimit të Bashkisë Vorë.

Kandidati ka të drejtë të bëjë ankım me shkrim në Komisionin Përzgjedhës për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga:

- a) data e njoftimit të rezultatit të verifikimit paraprak të kandidatit;
- b) data e njoftimit të rezultatit të vlerësimit me shkrim;
- c) data e njoftimit të rezultatit të testimit të aftësive fizike;
- ç) data e njoftimit të rezultatit të vlerësimeve për kandidatët, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të përcaktuara.

Komisioni përzgjedhës njofton vendimin brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimore.

Në përfundim të këtij afati, njësia e burimeve njerëzore publikon listën përfundimtare fituese.

Shkresa përpilohet në 4 (katër) kopje.

KRYETARI

Blerim Shera

